



DOKUMENT QË PËRMBAN INFORMACION MBI TARIFAT

Ofruesi i shërbimeve të pagesave: Raiffeisen Bank SH.A.

Data: 04 Prill 2024

- Ky dokument ju informon për tarifën për përdorimin e shërbimeve kryesore të lidhura me llogarinë e pagesës me shërbime bazike. Kjo do t'ju ndihmojë të krahasoni këto tarifa me ato të llogarive të tjera.
- Tarifën mund të zbatohen gjithashtu për përdorimin e shërbimeve të lidhura me llogarinë të cilat nuk janë të listuara këtu. Informacioni i plotë parakontraktor është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit të Raiffeisen Bank sh.a., të aksesueshëm nëpërmjet linkut [Tarifa dhe kushte \(raiffeisen.al\)](https://tarifa.dhe.kushte.raiffeisen.al) dhe gjithashtu e afishuar në të gjitha njoftimet e ambienteve të Bankës.
- Një fjalor i termave të përdorur në këtë dokument është në dispozicion falas.

Shërbimi	Tarifa
Shërbime të përgjithshme të llogarisë	
Mirëmbajtja e llogarisë	75 Lekë/ Muaj
Hapje llogarie	0 Lek
Depozitim fillestar dhe balanca minimale e mbetur	0 Lek
Mbyllje llogarie	0 Lek
Depozitimet	0 Lek
Pagesat (me përjashtim të kartave)	
Pagesa automatike të faturave utilitare (Direct Debit)	
Paketa Bazike Me Page	50 Lekë
Transferta në Nisje në LEK brenda Shqipërisë (dege)	
Paketa Bazike Me Page	0.0165%; Min.250- Max.750Lekë
Transferta në Nisje në LEK brenda Shqipërisë (online)	
Paketa Bazike Me Page	Deri në 20,000 Lekë pa komision Mbi 20,000 Lekë 0.0165%; Min.250- Max.750Lekë
Transferta Ndërkombëtare në nisje (degë)	

Paketa Bazike Me Pagese	0.17%; Min 10 max 150 EUR 0.17%; Min.14 - Max.195 USD 0.17%; Min.9 - Max.125 GBP 0.17%; Min.14 CHF - Max.185 CHF
Transferta Ndërkombëtare në nisje (online)	
Paketa Bazike Me Pagese	10% zbritje ne komisionin minimal te deges
Transferta Kombëtare në Mbërritje ne Lekë	
Paketa Bazike Me Pagese	0 Lekë
Transferta Ndërkombëtare në Mbërritje ne Lekë	
Paketa Bazike Me Pagese	0 Lekë
Paketa Bazike FALAS	
Te gjitha pagesat me siper per segmentin “Paketa Bazike Falas” do te jene pa komision pervec pagesave Nderkombtare ne nisje	0 Lekë
Kartat dhe tërheqjet në para fizike	
Tërheqjet në para fizike	
Tërheqje cash pa njoftim paraprak për shuma më të madhe se 500.000 ALL (ekuivalente monedha tjera)	1% e shumës mbi limit
Tërheqje cash në Lekë deri ne limitin e ATM 500.000 ALL	50 Lekë
Kartë Debiti	
Paketa Bazike me Pagese	
Komision Mujor për Kartën e Debitit lëshuar për llogarinë (Mujor)	0 Lekë
Tarifa totale vjetore	0 Lekë
Komision lëshimi për kartë të re	0 Lekë
Rinovimi normal i kartës nga Banka	0 Lekë
Riprintim i kartës me kërkesën e klientit	200 Lekë
PIN-i i ri ose riprintim i PIN-it me kërkesën e klientit	100 Lekë
Tërheqje cash në ATM-të e RBAL	0 Lekë
Tërheqje cash brenda vendit në ATM-të jo te RBAL	1.25% (Min. 150)
Tërheqje cash në sportelet e RBAL (Manual Cash)	0 Lekë

Tërheqje brenda vendit në sportelet jo të RBAL (Manual Cash)	2.75% (Min. 200 Lekë)
Tërheqje cash ne ATM-te jashtë vendit	2% (Min. 150 Lekë)
Tërheqje në sportelet jashtë vendit (Manual Cash)	2.5% (Min. 250 Lekë)
Tërheqje cash brenda vendit në Pikat e Shitjes (POS) jo të RBAL	1.25% (Min. 150 Lekë)
Tërheqje cash në Pikat e Shitjes (POS) jashtë vendit	2% (Min. 150 Lekë)
Verifikim Bilanci në ATM-të e RBAL (VISA)	0 Lekë
Verifikim Bilanci në ATM-të e RBAL (Mastercard Debit)	0 (mbi 5 BE/muaj: 3 Lekë/ BE)
Verifikim Bilanci brenda vendit në ATM-të jo të RBAL	50 Lekë
Verifikim Bilanci në ATM-të jashtë vendit	50 Lekë
Nxjerrje llogarie e shkurtër (vetem në ATM të RBAL)	12 Lekë
Pagesa në Pikat e Shitjes (POS) të RBAL	0 Lekë
Pagesa në Pikat e Shitjes (POS) brenda vendit jo të RBAL	0 Lekë
Pagesa në Pikat e Shitjes (POS) jashtë vendit	1.5 %
Bllokim i përkohshëm (duke përfshirë edhe zhbllokimin e kartës)	250 Lekë
Bllokim të përhershëm të kartës me kërkesë të klientit (Mbyllje e kartës)	0 Lekë
Paketa Bazike FALAS	
Të gjitha Tarfiat dhe Komisionet e aplikuara për Kartë debiti janë 0 Lekë për paketën “Bazike Falas”.	0 Lekë

Fjalor për Termat dhe Përkufizimet e shërbimeve më përfaqësuese

Lista e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me llogarinë e pagesës:

Mirëmbajtja e llogarisë: Ofruesi i shërbimeve të pagesave administron llogarinë, duke bërë të mundur që konsumatori ta përdorë atë.

Debitim direkt: Është një shërbim pagese për debitimin e llogarisë së pagesës së konsumatorit, ku një transaksion pagese iniciohet nga përfituesi i pagesës, në bazë të pëlqimit që konsumatori i ka dhënë përfituesit të pagesës, ofruesit të shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës ose ofruesit të shërbimit të pagesave të vetë konsumatorit.

Pagesa periodike: Ofruesi i llogarisë kryen transferime të rregullta, sipas udhëzimit të konsumatorit, të një shume fikse parash nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër.

Transferta në nisje brenda Shqipërisë nëpërmjet platformës online: Ofruesi i llogarisë transferon fonde, sipas udhëzimeve të konsumatorit, nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër brenda Shqipërisë, nëpërmjet platformës online.

Transferta në nisje jashtë Shqipërisë nëpërmjet platformës online: Ofruesi i llogarisë transferon fonde, sipas udhëzimeve të konsumatorit, nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër jashtë Shqipërisë, nëpërmjet platformës online.

Transferta në nisje brenda Shqipërisë në degë: Ofruesi i llogarisë transferon fonde, sipas udhëzimeve të konsumatorit, nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër brenda Shqipërisë, nëpërmjet rrjetit të degëve të ofruesit të llogarisë.

Transferta në nisje jashtë Shqipërisë në degë: Ofruesi i llogarisë transferon fonde, sipas udhëzimeve të konsumatorit, nga llogaria e konsumatorit në një llogari tjetër jashtë Shqipërisë, nëpërmjet rrjetit të degëve të ofruesit të llogarisë.

Transferta në mbërritje brenda Shqipërisë: Kur fondet dërgohen në llogarinë e konsumatorit nga një llogari brenda Shqipërisë.

Transferta në mbërritje jashtë Shqipërisë: Kur fondet dërgohen në llogarinë e konsumatorit nga një llogari jashtë Shqipërisë.

Tërheqja e fondeve në para fizike brenda Shqipërisë nëpërmjet kartës së debitit: Konsumatori tërheq fonde në para fizike nëpërmjet kartës së debitit nga llogaria e tij në një ATM brenda Shqipërisë.

Tërheqja e fondeve në para fizike jashtë Shqipërisë nëpërmjet kartës së debitit: Konsumatori tërheq fonde në para fizike nëpërmjet kartës së debitit nga llogaria e tij në një ATM jashtë Shqipërisë.

Pagesa me kartë debiti brenda Shqipërisë: Konsumatori përdor kartën e tij të debitit për të kryer një pagesë brenda Shqipërisë. Kjo pagesë mund të kryhet në një dyqan ose në internet.

Pagesa me kartë debiti jashtë Shqipërisë: Konsumatori përdor kartën e tij të debitit për të kryer një pagesë jashtë Shqipërisë. Kjo pagesë mund të kryhet në një dyqan.